



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 211, datë 25.04.2024**

**PËR**

**KOMANDIMIN E ZNJ. {...}  
SI NDIHMËSMAGJISTRATE NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. nr. 68, datë 15.02.2024, “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidaturë nga radhët e gjyqtarëve”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, dërguar me Shkresën nr. 1696 prot., datë 02.04.2024, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
2. Afati i komandimit është 5(pesë) vjet dhe fillon më datë 01.06.2024.
3. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit.
4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtarës zn. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**